



| | | | |
|---|--|--|-------------|
| REPUBLIKA E KOSOVËS QEVERIA E KOSOVËS SEKTORI I ARKIVES | REPUBLIKA KOSOVA VLADA KOSOVA SEKTOR ARCHIVE | REPUBLIC OF KOSOVA GOVERNMENT OF KOSOVA ARCHIVE SECTOR | |
| Nr. Njësia Org. Org. Le. linice Org. Unit | 01 | Nr. Prot. Broj Prot. Prot No: | 56812 |
| Nr. i faqeve Ile. stranica No. pages | - 4 - | Data: Datum: Date: | 01/05/20 20 |
| Prishtinë/a | | | |

Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada-Government

Zyra e Kryeministrit - Ured Premijera - Office of the Prime Minister

| | |
|-------------------------------|---|
| REFERENCË: | 145 /2020 |
| Data/e | 01.05.2020 |
| PËR/ZA/TO: | Znj. Arta RAMA, Kryetare e Gjykatës Kushtetuese |
| CC: | Z. Milot VOKSHI, Sekretar i Përgjithshëm në Gjykatën Kushtetuese Z. Fitim KRASNIQI, Sekretar i Përgjithshëm në ZKM |
| NGA/OD/FROM: | Albin Kurti, Kryeministër në detyrë i Republikës së Kosovës |
| TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT: | Përgjigje në kërkesën për vendosjen e masave të përkohshme në rastin nr. KO 72/20 |

E nderuara znj. Rama,
Të nderuar gjyqtarë të Gjykatës Kushtetuese,

Qeveria pas shqyrtimit të kërkesës së dorëzuar nga 30 deputetët e Kuvendit të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Parashtruesit e kërkesës), përmes të cilës në merita kontestojnë dekretin e Presidentit të Republikës së Kosovës Nr. 24/2020 të datës 30.04.2020 (në tekstin e mëtejme: akti i kontestuar), ndërsa të njëjtës i është bashkangjitur edhe kërkesa për vendosjen e masave të përkohshme ndaj aktit të kontestuar, vlerëson se në përputhje me nenin 116 paragrafi 2 të Kushtetutës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta), nenin 27 të Ligjit Nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Ligji), Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës duhet të aprovojë kërkesën e parashtruesve për vendosjen e masave të përkohshme ndaj aktit të kontestuar dhe të pezullojë efektet juridike të tij deri në një vendim përfundimtar.

1. Qeveria e mbështet vlerësimin e saj në praktikën e Gjykatës e cila në raste të cilat kanë pasur për objekt shqyrtimi vendimet për zgjedhjen apo vendimet për propozimin për t'u zgjedhur në një tërësi ndër pozitave kryesore të organeve

kushtetuese, të të gjitha degëve të pushtetit, sipas kërkesës së palës në procedurë ka vendosur masat e përkohshme dhe ka pezulluar procedurën e mëtutjeshme.

2. Kësisoj, me vendimin e saj të datës 23.07.2014 në rastin Nr. KO 119/14, Gjykata kishte aprovuar kërkesën e parashtruesve dhe kishte pezulluar vendimin e Kuvendit të Kosovës Nr. 05-V-001 të datës 17.07.2014 për zgjedhjen e Kryetarit të Kuvendit, me arsyetimin se e njëjta ishte *prima facie* e pranueshme ngase e njëjta ishte parashtruar nga numri i nevojshëm i deputetëve që kërkohet për të kontestuar një vendim të Kuvendit dhe e njëjta ishte parashtruar brenda afatit ligjor. Këto dy kritere Gjykata i kishte konsideruar si argumente bindëse pse duhet të aprovohet masa e përkohshme.
3. Nën arsyetimin se parashtruesi kishte paraqitur një rast *prima facie*, Gjykata kishte aprovuar kërkesën e tij përmes vendimit të datës 04.04.2014 në rastet KI99/14 dhe KI100/14, përmes të cilit kishte vendosur masat e përkohshme ndaj vendimit për zgjedhjen e Kryeprokurorit të Shtetit.
4. Duke konsideruar si arsye substanciale për interesin publik, administrimin e duhur të sistemit të drejtësisë, Gjykata kishte aprovuar kërkesën e parashtrueses në rastin KI34/17 dhe kishte pezulluar procedurën e dekretimit të Kryetarit të Gjykatës Supreme nga Presidenti i Republikës së Kosovës.
5. Qeveria vëren se në të gjitha rastet kur është kontestuar para Gjykatës zgjedhja e udhëheqësit të legjislativit, gjyqësorit dhe prokurorisë janë vendosur masat e përkohshme nga Gjykata.
6. Qeveria thekson se në rastin Nr. KO 29/11, parashtruesit e kërkesës nuk kishin kërkuar vendosjen e masave të përkohshme kur kishin kontestuar vendimin e Kuvendit për zgjedhjen e Presidentit të Republikës së Kosovës. Prandaj edhe ky rast dallon nga rastet e lartpërmendura.
7. Në dritën e praktikës së etabluar të Gjykatës, përmes të cilës ka materializuar normat kushtetuese dhe ligjore në lidhje me vendosjen e masave të përkohshme, Qeveria vëren se një kërkesë konsiderohet si *prima facie* e pranueshme në rast se ajo është dorëzuar nga numri i mjaftueshëm i deputetëve dhe e njëjta është dorëzuar brenda afatit të përcaktuar kohor.
8. Duke marrë parasysh se kërkesa është dorëzuar sipas nenit 113 paragrafi 2(1) i Kushtetutës dhe nenet 29 dhe 30 të Ligjit, kërkohet që kërkesa të jetë nënshkruar nga 30 deputetë dhe që e njëjta të jetë dorëzuar në Gjykatë brenda afatit gjashtë (6) mujor pas hyrjes në fuqi të aktit të kontestuar. Parashtruesit e kërkesës janë 30 deputetë të Kuvendit të Kosovës dhe kërkesën kundër aktit të kontestuar e kanë dorëzuar brenda afatit të përcaktuar me ligj. Dekreti i Presidentit Nr. 24/2020 ka hyrë në fuqi me datën 30.04.2020, ndërsa parashtruesit e kanë dorëzuar kërkesën të njëjtën ditë

9. Për më tepër, parashtruesit e kërkesës **kanë saktësuar cili akt** i Presidentit po kontestohet, **kanë ofruar argumente** në lidhje me pretendimet e tyre të cilat burojnë **nga Aktgjykimet e Gjykatës Kushtetuese të Kosovës dhe praktika kushtetuese parlamentare dhe institucionale në Republikën e Kosovës**. Parashtruesit **kanë saktësuar cilat dispozita kushtetuese** i cenon akti i kontestuar dhe kanë **ofruar argumentet e tyre** në lidhje me pretendimin për **shkeljen e secilës dispozitë kushtetuese**.
10. Prandaj parashtruesit kanë plotësuar kriterin e përcaktuar nga dispozitat kushtetuese dhe ligjore të cilat janë materializuar përmes vendimeve të Gjykatës që kërkesa e tyre të konsiderohet si *prima facie* e pranueshme dhe që Gjykata të vendos masat e përkohshme.
11. Po ashtu, Qeveria e Republikës së Kosovës i është drejtuar Komisionit të Venedikut me një kërkesë për dhënie të opinionit në lidhje me rolin e Presidentit të Republikës së Kosovës në shpërndarjen e detyrueshme të Kuvendit pas një mocioni të suksesshëm mosbesimi dhe obligimin e tij për të shpallur zgjedhjet, në përputhje me nenin 82.2 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës; dhe, në lidhje me Kompetencat e Presidentit në formimin e Qeverisë. Komisionit të Venedikut i është kërkuar dhënia e një opinionit pikërisht në lidhje me situatën e krijuar pas veprimeve dhe dekretit të Presidentit. Pra, për të njëjtën çështje e cila është në shqyrtim para Gjykatës.
12. Po ashtu, fakti se situata nëpër të cilën po kalon Kosova, pra **javët më kritike në luftimin e infeksionit COVID-19**, kërkojnë që të mos krijohet hendek institucional, si rezultat i të cilit do të mund të rrezikohej jeta dhe shëndeti i qytetarëve të Kosovës.
13. Për më tepër, cilido vakum institucional apo cilido procedim tutje në rrethanat e pakënaqësisë masive të manifestuar nga qytetarët e Republikës së Kosovës do të mund t'i shërbente daljes nga kontrolli të menaxhimit të infeksionit COVID-19. Deri më tani, qytetarët kanë respektuar të gjitha masat e propozuara nga Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës dhe të aprovuara nga Ministria e Shëndetësisë, mirëpo një hendek institucional do të mund të shkaktonte një anashkalim të këtyre masave të domosdoshme për jetën dhe shëndetin e qytetarëve.
14. Në situata të ngjashme sikurse Republika e Kosovës, shtetet kanë hequr dorë nga betejat politike me qëllim që t'i lejohet qeverive të tyre që të marrin të gjitha masat e nevojshme që të tejkalohet pandemia. Në dritën e këtyre fakteve, do të ishte edhe në interes publik që Gjykata Kushtetuese të vendoste masat e përkohshme ndaj dekretit të Presidentit deri në krijimin e kushteve të përshtatshme për realizim të jetës politike dhe publike.

15. Qeveria duke u bazuar në arsyetimin faktik dhe juridik të parashtruar më lart, i kërkon Gjykatës Kushtetuese që të vendos masat e përkohshme ndaj dekretit të Presidentit të Republikës së Kosovës, pa paragjykuar vendimin përfundimtar të Gjykatës.
16. Përfundimisht, Qeveria vlerëson se Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës duhet të aprovojë kërkesën e tyre për masë të përkohshme, sepse parashtruesit kanë dorëzuar një kërkesë e cila **(1)** është *prima facie* e pranueshme, **(2)** është substancialisht e arsyetuar rreth pretendimeve përkitazi me **(3)** dispozitat kushtetuese të saktësuara në kërkesë. Po ashtu, vendosja e masave të përkohshme është **(4)** në interesin publik, **(5)** i shërben administrimit të drejtësisë (administrimit pa presion kohor të rastit).

Kryeministri në detyrë i Republikës së Kosovës

Albin Kurti


